VENDIM
Nr. 94, datë 28.7.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC KABASH POROCAN" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37 germa "d" dhe 110 të ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë eklektike", nenit 4 pika 1 germa "g", neni 5 pika 2 dhe neneve 13 dhe 14 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.7.2015, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "HEC Kabash Porocan" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

1. Shoqëria "HEC Kabash Porocan" sh.p.k. ka aplikuar për t'u pajisur me licencë për tregtimin energjisë elektrike në datën 13.5.2015 në zbatim të ligjit nr. 9072, datë 23.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar. Bordi i ERE-s me vendimin nr. 77, datë 8.6.2015, miratoi fillimin e procedurave për tregtimin e energjisë të shoqërisë "HEC Kabash Porocan" sh.p.k.

2. Njoftimi i kërkesës për licencim të këtij subjekti është kryer në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 9072 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

3. Në datën 15.5.2015 ka hyrë në fuqi ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

4. Në ligjin nr. 43/2015, neni 110 pika 1, është parashikuar që ligji nr. 9072, datë 22.5.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" shfuqizohet.

5. Në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", në zbatim të detyrimeve që burojnë nga vetë ligji në nenin 39 dhe nenin 108 pika 3 të tij, në nenin 110 pika 2 të tij, parashikohet se: Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.

Për sa më sipër dhe duke qenë se aplikimi i shoqërisë "HEC Kabash Porocan" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "HEC Kabash Porocan" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30- vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti